



VENDIM

Nr. 56, Datë 18.04.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETETEVE TË SHOQËRISË “ALB ENERGY” SH.P.K, NË FAVOR TË “BANKËS SOCIETE GENERALE ALBANIA” SH.A.

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a”; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.04.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k, për lënie peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorit të Tregut,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gërmat:
 - “a” ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licensuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit, është plotësuar;
 - “b” - veprimtaria e licensuar, është plotësuar;
 - “c” - gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve, është plotësuar;
 - “d” - përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare, është plotësuar;
 - “e” - arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit, është plotësuar;

- “f” - efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është plotësuar;
- “g” - efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar, është plotësuar;
- “h” - marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen, është plotësuar;
- “i” - deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, është plotësuar;
- “j” (Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera me herët nga I njëjti subjekt) është plotësuar;

Nëse Bordi i ERE-s e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë informacion shtesë nga i licensuari i cili duhet ta dërgojë informacionin e kërkuar brenda 8 ditëve nga marrja e njoftimit, në bazë të pikës 5 të nenit 7 të “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ Alb Energy” sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI

**ASETET QË SHOQËRIA “ALB ENERGY” SH.P.K, KA KËRKUAR TË
LËRË PENG NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE
ALBANIA” SH.A,**

a) Çertifikatë nr. 548628; përshkrimi i pasurisë:

Hec “BELE 2” disponon ndërtesën me $S= 609m^2$,

Tubacion 1502m

Vepra e marrjes sip= $235m^2$

Sipërfaqe trualli = $16.594 m^2$,

b) Çertifikatë nr. 548626; përshkrimi i pasurisë:

“Hec Topojan 1” disponon ndërtesën $S= 372m^2$,

Tubacion 1502m

Sipërfaqe trualli, $S =4641 m^2$,

c) Çertifikatë nr. 548650; përshkrimi i pasurisë:

Nënstacion, $S =932m^2$